

Natyra njerëzore: nga ushtrimi i pushtetit në veprime racionale

Copyright © Kjo është hyrja e librit tim të parë, 'Revolucion për demokraci gjithëpërfshirëse dhe Fronetike', Dudaj 2013.

Ylli Përmeti

Abstrakt: në një kënd të largët të universit na ishin ca kafshë të cilat zbuluan se ç'është "besimi shqisor": ato besojnë me sy kur shikojnë, besojnë me gojë kur shikojnë, besojnë me vesh kur dëgjojnë dhe, besojnë me mendje kur mendojnë. Por një kafshë tjetër, njeriu, dhe vetëm njeriu, beson me mendje në një shkallë më të lartë kur në të krijohet realiteti.

Kur në vitin 1997-të në Shqipëri plasi lufta civile unë isha një adoleshent dhe kurseja mundin tim në mërgim. Por të gjitha ato kursime, që bëra me sakrificë dhe vetë-mohim, shkuan, njëloj si shumicës së shqiptarëve, te gostitë e elitës vendore. Kryeministri Berisha, si shkaktari kryesor i krijimit të piramidave, luftës dhe humbjeve tragjike që pasuan në vend, u shfajësua me argumentin se nuk i tha ai popullit që të investonte atje ku investoi, por zgjedhja e tij! Në të vërtetë, ai bashkë me klasën politike, e cila vazhdon ende sot të sundojë...pasi lejoi hajdutët me të cilët bashkëpunoi për të krijuar piramidat plotësuese të tregut të marketingut, përkrah "bankave fraksionale", të cilat janë piramida të një lloji tjetër,¹ si gjithë homologët e tij të pacipë, u shfajësua dhe vazhdon të shfajësohet me fjalën 'zgjedhje' pavarësisht se pushtetin e ushtron ajo! Dhe pavarësisht asaj tragjedie dhe shkatërrimi kombëtar, ai vazhdon ende të gëzojë privilegjet që i kanë krijuar, me mbështetje të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë, elitat e huaja, qoftë edhe pas 15 vjetësh! Për të njëjtën arsye vendosa të studioja sistemin kapitalist dhe "demokracinë" përfaqësuese, se si operonte në teori, përtej botës që përjetoja në praktikë: si të thuash, në një dorë veglat e punës dhe në tjetrën librat, pavarësisht vështirësive në vend të huaj. Doja të zbërtheja gjithçka. Gradualisht u ktheva në një enciklopedi të vogël. Duke përjetuar një katastrofë socio-ekologjike, hulumtuar dhe kundruar sistemin modern,

¹ Shih, Miti i progresit dhe themelet e njohurisë, pjesa e parë.

gjithashtu dhe paradigmën sociale pararendëse, kuptova se me njohurinë që kisha grumbulluar nuk e shpëtoja dot veten —ose, mund ta shpëtoja përkohësisht, nëse manipulova dhe unë si gjithë të tjerët. Por meqë jetoj edhe unë brenda të njëjtës katastrofë dhe dija shkaqet dhe pasojat, ishte si të mos bëja asgjë.

Kështu, në kuadër të një krize shumë-dimensionale që ka përfshirë botën, ky Projekt synon të tregojë dhe të dëftojë shkaqet e krizës përkatëse dhe të paraqes një rrugëzgjidhje përmes një kuadri tjetër institucional. Teza që përpunohet dhe zhvillohet në këtë studim përgënjeshtrohet kryesisht shkencat politike, sociale, ekonomike dhe filozofike të modernitetit, dhe në disa aspekte, edhe shkencat e natyrës. Për shembull, shkencat mjekësore përjashtojnë përfshirjen e 'pushtetit' të njeriut në vendimmarrje, ku zhvillohet mes të tjerash besimi demokratik dhe siguria, dhe mundohen të kurojnë simptomat sociale (stres etj.) jashtë përfshirjes në fjalë. Nuk e kuptojnë shkollarët e këtyre "shkencave" se në sajë të përqendrimit të pushtetit në një anë dhe shpërqendrimit në anën tjetër, krijohen kushtet për 'pasiguri' lidhur me të ardhmen, dhe pasiguria, me radhë, krijon stresin dhe stresi krijon gjithë efektet e tjerë anësorë. Problemi kryesor, rrjedhimisht, është se kur shkencat moderne orvaten të dëftojnë shkaqet e problemeve shëndetësore, sociale dhe ekologjike, ato nuk përfshijnë konsideratat të qarta sistemike dhe pushtetologjike kur dihet se çdo sistem ose regjim nënkupton një lloj pushteti: ose monarkik, ku monarku ushtron pushtetin; ose oligarkik, ku oligarkia ushtron pushtetin; ose demokratik, ku tërësia e një populli ushtron pushtetin.

Për të njëjtën arsye problemet ekonomike me të cilët përballet vendi ynë dhe gjithë vendet e tjerë të integruar pjesërisht apo plotësisht në globalizmin neoliberal, nuk janë si pasojë e mos-integrimit të vendit tonë në Bashkimin Europian, siç mundohet elita jonë ta paraqesë gjendjen apo të mungesës së reformave ekonomike (privatizimeve) siç na thotë Brukseli dhe institucionet ndërkombëtare. Përkundrazi, ato janë, në një anë, pasojë e mungesës së dijes së klasës politike shqiptare për të kuptuar natyrën e demokracisë, natyrën e natyrës njerëzore dhe efektet që krijon (mos)ushtrimi i pushtetit në ndërgjegjjen dhe virtytet e një populli. Për pasojë, politikanët profesionistë imitojnë shabllonin politik që ndjekin homologët e tyre në vende të tjerë. Elita vendore bashkë me elitat e huaja, siç do të tregoj në këtë studim,² jo vetëm që nuk mund ta zgjidhin problemin e ekonomisë, katastrofën ekologjike dhe shëndetin e përgjithshëm të popullit, me orientimin e përgjithshëm të tij, d.m.th përmes transferimit të një pjese të

² Dua të them, në gjithë kapitujt e librit.

madhe të pushtetit të “demokracisë” parlamentare në kuintat e Brukselit dhe përmes integritit tonë në globalizmin neoliberal por me orientimin në fjalë ajo do ta përkeqësojë krizën aq sa vendi ynë do të përfshihet nga një destabilizim ekonomik, politik, social dhe katastrofë të mëtejshme ekologjike saqë as Brukseli dhe as “demokracia” e tij nuk do të ketë mundësi t’i japë zgjidhje. As është shkaku i krizës shumë-dimensionale aktuale pasojë e kapitalizmit dhe prirjeve të tij, siç analizojnë “ekonomistët” ortodoksë (Krugman, Wolf etj.) dhe të paaftësisë së sistemit socialist për të shpërndarë të ardhura, siç pohon Ramiz Alia.³ Por ajo është pasojë e përqendrimit të pushtetit politik dhe ekonomik në pak duar. Ky përqendrim bëhet i mundur përmes ndarjes së ‘pushtetit’ ekonomik dhe politik nga populli (polity) dhe mungesës së ndërveprimit të njohurisë teorike dhe praktike (urtësisë praktike, ligjore, politike dhe filozofike) që zhvillohet përgjatë ushtrimit të pushtetit.

Kështu, pasi tregoj gjysëm të vërtetat e disa mendimtarëve të botës moderne (në kampin kapitalist Adam Smithin, Monteskienë dhe Paul Krugman-in e të tjerë pas tyre dhe në kampin socialist Marksini dhe post-marksistët), ky Projekt paraqet një “globalizim” të ri, i cili, nëse bota është për t’u shpëtuar, kryesisht nga katastrofa ekologjike, një luftë tjetër dhe diktature botërore, ajo nuk duhet të orientohet drejt unioneve ekonomike, ku pushteti (politik dhe ekonomik) përqendrohet gjithnjë dhe më shumë në më pak duar, siç po veprojnë elitat kapitaliste të modernitetit neoliberal me mbështetjen e popujve të zhytur në padije, por drejt demokracisë politike, ekonomike, sociale dhe ekologjike. Kuadri institucional që propozon ky studim është sa i domosdoshëm për t’u shqyrtuar, kundruar dhe konkretizuar nga shoqëritë e botës sonë, aq edhe urgjent. Lexuesi, studiuesi dhe qytetari i zakonshëm, përpara se të nxjerrë përfundime, duhet ta lexojë të gjithë studimin. Kështu që të përbushë kërkesat akademike një “Manifest Politik” apo ai duhet të analizojë plotësisht tre presupozime bazë:

- *Ai duhet të bartë analizën e realitetit të sotëm dhe të dëftojë shkaqet e krizave sociale;*
- *Ai duhet të tregojë raportet sistemike të sistemeve sociale dhe efektet e pushteteve përkatës mbi shoqëritë;*
- *Ai duhet të tregojë natyrën e pushtetit dhe kuadrit institucional që ai krijon dhe nëse është e keqe, ta ndryshojë atë. Për të njëjtën arsye ai duhet të bartë propozimet e tij për*

³ Shpresa dhe zhgënjime, Ramiz Alia, Tiranë 1993.

një kuadër të ri institucional, përmes të cilit duhet të përmbysë kuintesencën e institucioneve aktuale dhe të ravigjëzojë një strategji konkrete tranzitore.

Ky studim shqyrton natyrën njerëzore, konceptet që vërtiten rreth njeriut dhe parashikon të ardhmen. Kështu, ndryshe nga politika, e cila nën disa kushte specifike, shqetësohet për programin, i cili në një përcaktim të ngushtë është një konkretizim i përkohshëm i objektivit të projektit mbi disa pika gjykuar që të jenë thelbësore në rrethana të dhëna, për sa i takon realizimit të tyre që do të çojnë atje ose do të lehtësojnë realizimin e projektit si të tërë me dinamikat e tij të brendshme, në fjalë të tjera, **një program është vetëm një figurë fragmentare dhe e përkohshme i projektit**, ndërsa **projekti kujdeset për realizimin e tij si një çast domethënës... bërthama e Projektit është një kuptim dhe një orientim (një drejtim drejt), i cili nuk mund të fiksohet në ‘ide të qarta dhe të dallueshme’ dhe që shkon përtej paraqitjes së projektit, sikur ai të ishte fiksuar në çdo çast të dhënë.**⁴ Ndërsa programi mund të rrënohet ose degjenerohet gjatë realizimit të tij, **projekti synon një objektiv më të lartë: autonominë ose lirinë e individit dhe shoqërisë.**

Politika⁵ nuk është as konkretizimi i një njohurie absolute, as teknikë; as nuk është ajo një dëshirë e verbër e dikujt që di diçka. Ajo bën pjesë në një fushë tjetër, **të bërjes** dhe në veçorinë metodike të bërjes quajtur *praxis*; praxis është ajo çfarë synon zhvillimin e autonomisë si fundi i saj dhe, për këtë fund, ajo përdor autonominë si mjet. Teknika është një projekt që kuptimi i saj mbetet i pasigurt, që pjesët e saj janë të errëta dhe fundi i saj është i papërcaktuar, meqë për të qenë i sigurt, ideja që të bëjmë veten tonë ‘mjeshtër dhe zotërues të natyrës’ është të thuash të drejtën pa kuptim.⁶ Politika, nëse kuptohet drejtë, është në natyrën e njeriut. Për të njëjtën arsye, ky Projekt e fillon hulumtimin e tij nga ‘natyra e njeriut’ dhe e përputh atë në shoqëri, duke e çliruar dhe zhvilluar përmes një kuadri tjetër institucional. Dhe natyra e njeriut, ndryshe nga shumica e kafshëve të tjera, të cilat procedojnë kryesisht përmes shqisave (sy, vesh, gojë), procedon kryesisht përmes mendjes. Megjithëse në vend tjetër e shqyrtoj më hollësisht konceptin e mendjes, ndërgjegjjes dhe trurit,⁷ këtu po citoj se mendja jonë procedon përgjithësisht përmes *pesë episodeve* në lidhje me veten, kontekstin dhe lëvizjen:

⁴ Konelios Kastoriadis, The imaginary institution of society, f, 78.

⁵ Shih për më shumë, Kapitullin Dhjetë, sepse politika është më shumë se kaq.

⁶ Po aty.

⁷ The Complete theory of Health.

1. **Uni, Egoja, apo Vetja,**⁸ është koha kur një njeri kujton veten si një fëmijë. Kjo kohë ndryshon nga njëri te tjetri, por ajo mund të jetë rreth moshës dy deri pesë vjet.⁹ Sepse, siç konkludojnë edhe neuroshkencëtarët,¹⁰ zhvillimi i trurit fillon para lindjes dhe kulmon në moshën pesë vjeçare pavarësisht se ai zhvillohet edhe përgjatë fazave të tjera të jetës.
2. **Vrojtimi përmes shqisave dhe mendimit** refleksiv përgjatë kohës kur kërkojmë të mundësojmë një lloj veprimi në shërbim të vetes sonë;
3. **Racionalizimi** i veprimeve shfaqet kur dikush konsideron të mirën dhe të keqen e një veprimi në lidhje me veten dhe botën e jashtme. Ky proces përfshin ndërgjegjjen dhe imponon një lloj metodologjie në varësi të kontekstit; (çdonjëri e demonstroi ndryshe metodologjinë në fjalë; kjo është kështu sepse perceptimi dhe rrjedhimisht refleksionet e njerëzve ndryshojnë nga njëri te tjetri);
4. **Moralizimi** shfaqet kur një njeri krijon në mendjen e tij parametra dhe standarde sociale në lidhje me vetë veprimin dhe, në fund;
5. **Veprimi** shfaqet me aktivitetet fizik ose praksis që falë natyrës njerëzore, teleologjike, dihet paraprakisht **fundi** i tij.

Episodi i parë lidhet më shumë me kujtesën (trurin) ndërsa katër episodet e tjerë me lëvizjen aktuale (mendjen). Ndryshe nga “shkencëtarët” e modernitetit, Aristoteli, e lidh kujtesën drejtpërdrejt me dëgjimin, perceptimin dhe mendimin. Ndaj dhe **kujtesa**, sipas tij, **nuk është as Perceptim as Konceptim, por një gjendje e ndikuar nga këto të treja, —dëgjimi, perceptimi dhe mendimi— e kushtëzuar nga intervali kohor.** Gjithë kujtesa, rrjedhimisht, nënkupton një interval kohor; rrjedhimisht vetëm ato kafshë që perceptojnë kohën kujtojnë, dhe organi përmes të cilit ata perceptojnë kohën është gjithashtu ai përmes të cilit ata kujtojnë. Por cili është ky “organ”? Aristoteli sqaron se ndërsa ndikimi (ose paraqitja) është aktuale, dhe fakti (përkatës) mungon, ky i fundit — i cili nuk është aktual— kujtohet. Është e qartë se ne duhet të përftojme shenjën që

⁸ Për shembull, disa psikologë e ndajnë zhvillimin e fëmijës në katër kategori; ato janë: **sensorimotor** (0-2 vjeç). Fëmijët gjatë kësaj kohe ndërtojnë njohuri përmes shqisave dhe direkt duke ndërvepruar me mjedisin e tyre; **paraoperacional** (2-7 vjeç), fëmijët mund të përdorin gjuhën, luajnë dhe simbolizojnë duke folur lidhur me atë që dinë rreth situatave të reja; **operacional konkret** (7-12 vjeç), fëmijët kuptojnë botën përmes mendimit logjikë dhe vendosin objektet në kategori; **operacional formal** (12 vjeç +) fëmijët fillojnë të kuptojnë botën përmes arsyetimit hipotetik dhe mendimit shkencor. Peek-a-boo: A window on baby's brain, BBC, 18 October 2013. Por, sipas eksperimenteve, fëmija arrin vetë-ndërgjegjësim, d.m.th kuptimin e vetë-dijshmërisë, rreth moshës 18 deri 24 muaj. BBC Horizon, The Secret You.

⁹ Në të vërtetë shkencëtarët përtacë, siç i quaj unë, më konkretisht, neurologët, s’e kuptojnë arsyen se pse ne nuk kujtojmë foshnjërinë tonë sepse s’e kuptojnë ku qendrojnë kujtimet dhe si formohen. S’kuptojnë, në fjalë të tjera, natyrën dhe zhvillimin e ndërgjegjjes, mendjes dhe shpirtit. The mystery of why you can't remember being a baby, BBC, 26 July 2016.

¹⁰ How children's brains develop – new insights, UNICEF, 14 May 2014.

gjenerohet përmes perceptimit shqisor në shpirtin ndijimor, dhe në pjesën e trupit që kujtesa qendron—domethënë, ndikimi prej të cilit ne quajmë kujtesë—për t'u shfaqur si një pikturë. Procesi i lëvizjes (nxitja ndijimore) përfshin veprimin e shenjave perceptuese në, siç ishte, një lloj përshtypje e perceptimit, thjesht siç veprojnë njerëzit kur bëjnë një shenjë ose përshtypje me një shenjë. Kjo sqaron se pse, tek ata që lëvizin fuqishëm për shkak të pasionit, ose koha e jetës, nuk formohet ndonjë shenjë kujtese; siç nuk do të krijohesh asnjë shenjë (ose përshtypje) nëse lëvizja e shenjës do të zhytësh në ujë të lëvizshëm; ndërsa atje janë të tjerë në të cilët, për shkak të cingërisjes së sipërfaqjes marrëse, siç ndodh mbi muret (mbi stuko) e vjetër (të dhomës), ose për shkak të ashpërsisë së sipërfaqjes marrëse, përshtypja e nevojshme nuk ngulitet aspak. **Ndaj dhe njerëzit shumë të rinj dhe shumë të vjetër janë me mungesë në kujtesë; ata janë në një gjendje rrjedhjeje: të parët për shkak të rritjes së tyre, të dytët, për shkak të shpërbërjes.** Në të njëjtën mënyrë, gjithashtu, ata që janë shumë të shpejtë dhe shumë të ngadaltë, kanë kujtesë të keqe. Të parët janë tejet të butë, të dytët tejet të ashpër (në teksturën ose ezencën e organeve të tyre), kështuqë në rastin e të parëve imazhi i paraqitur (megjithëse i ngulitur) nuk qendron në shpirt, ndërsa në të dytin nuk është ngulitur fare.¹¹

“Shkencëtarët” e kohëve tona, më konkretisht, neurologët, s’e kuptojnë arsyen se pse ne nuk kujtojmë foshnjërinë tonë sepse nuk kuptojnë ku qendrojnë kujtimet dhe si formohen. S’kuptojnë, në fjalë të tjera, natyrën dhe zhvillimin e ndërgjegjjes, mendjes dhe shpirtit.¹² Ndryshe nga këta “shkencëtarë”, Aristoteli e lidh kujtesën drejtpërdrejt me dëgjimin, perceptimin dhe mendimin dhe krijimin e figurave. Aristoteli sqaron se ndërsa ndikimi (ose paraqitja) është aktuale, dhe fakti (përkatës) mungon, ky i fundit — i cili nuk është aktual— kujtohet. Ndërsa kujtesa buron nga dëgjimi, perceptimi dhe mendimi, megjithëse dëgjimi është vetëm një perceptues i kafshëve, dhe kujtesa mund të reduktohet vetëm te “perceptimi dhe mendimi” —në rastin e parë -‘perceptimit’-, nënkuptohen gjithë shqisat perceptuese, dhe në të dytin, -‘mendimit’-, mendja, natyra e së cilës përshkruhet më poshtë— dhe arsyeja se pse ne nuk kujtojmë foshnjërinë tonë është për shkak të dinamikave fiziologjike që zhvillohen te njeriu, të cilat nuk lejojnë të krijohet ndonjë shenjë në kujtesë, ne duhet të kuptojmë lidhjen e ngushtë midis kujtesës dhe dijes. Aristoteli na ndihmon edhe në këtë çështje kur ai tregon pikërisht lidhjen e ngushtë të kujtesës me përvojën, dijen dhe shkencën:

¹¹ On memory and reminiscence, f, 1.

¹² The mystery of why you can't remember being a baby, *BBC*, 26 July 2016.

Ne duhet të zotërojmë një aftësi të një farë lloji [nga lindja], por jo të tillë saqë të radhisim me përpikmëri këto gjendje të zhvilluara. Dhe kjo të paktën është një karakteristikë e gjithë kafshëve, sepse ata zotërojnë një aftësi dalluese të lindur e cila quhet shqisë-perceptim. Por megjithëse shqisë-perceptimi është i bashkëlindur në gjithë kafshët, në disa, shqisë-përshtypja ngulitet, në disa jo. Kështu kafshët në të cilat kjo ngulitje nuk vjen për t'u sjellë ose s'kanë fare dije përtej veprimtarisë së perceptimit, ose s'kanë dije për objektet nga të cilët asnjë përshtypje nuk ngulitet; kafshët në të cilat ajo merr formë kanë perceptim dhe mund të vazhdojnë ta ruajnë shqisë-përshtypjen në shpirt: dhe kur kjo ngulitje përsëritet shpesh një dallim i mëtëjshëm menjëherë shfaqet mes atyre që nga ngulitja e shqisë-përshtypjeve të tilla zhvillohet një aftësi për sistematizimin e tyre dhe të atyre që nuk munden. Kështu nga shqisë-perceptimi krijohet ajo çka ne quajmë kujtesë, dhe nga kujtesat e përsëritura shpesh e të njëjtave gjëra zhvillohet përvoja; sepse një numër kujtesash përbëjnë një përvojë të vetme. Nga përvoja sërish—domethënë nga e përgjithshmja tashmë e ngulitur në tërësinë e saj në shpirt, njëra përbri shumë kujtesave e cila është një identitet i veçantë brenda tyre—buron aftësia e artizanit dhe dija e njeriut të shkencës: aftësia, në sferën e krijimtarisë; dhe shkencë, në sferën e qenies/ekzistencës.¹³ (Theksi u shtua)

Njerëzit që flasin me 'përshtypje', rrjedhimisht, siç flasin shpesh shumë "ekspertë" në masmedia, apo siç shkruajnë shumë, duke përdorur vetëm 'përshtypjen', u mungon qoftë përvoja qoftë dija shkencore. Kjo është arsyeja që ata –në padije- kur diskutojnë një problematikë, fillojnë me togfjalshin: "kam përshtypjen"! Rasti i parë, i "ekspertit", është krejtësisht i papërshtatshëm për të diskutuar një problematikë, meqëse ai përdor vetëm 'përshtypjen'. Kur përdoret kjo e fundit nuk përdoret përvoja dhe dija shkencore. Domethënë, dijen e shkaqeve të dukurisë apo dukurive që diskutohen. Sepse kur njeriu ka dije rreth një problematike, ai do të fillonte me togfjalshin: "kam bindjen se...". Kjo lloj 'bindje' buron nga përvoja dhe dija shkencore. Në të dytin, mirë do të ishte që asnjëri mos të tentonte të shkruante duke u bazuar në 'përshtypje': sepse jo vetëm që gabon por tregon se nuk e ka kuptuar se 'përshtypja' nuk është dije shkencore. Përkundrazi, 'përshtypje' mund të kenë të gjitha kafshët përse kohë që ato kanë shqisa – për të perceptuar botën e jashtme- dhe shpirt –për të ngulitur një përshtypje. Ndryshimi me kafshët e tjera fillon pikërisht kur njeriu zhvillon njëherësh përvojën dhe dijen shkencore. Ndryshe mbetet në nivelin e gjithë kafshëve të tjera. Nuk është e rastit që fjala 'përshtypje' nënkupton 'shtypjen' e botës së jashtme në botën e brendshme të njeriut. As nuk është e rastit që në greqisht përdoret fjala 'aisthisí' për 'përshtypjen'. Ajo nënkupton shqisat. Ndërsa në greqisht nënkuptohen shqisat ose organet përmes të

¹³ Posterior analytics, Aristotle, f, 44.

cilëve përshtypja krijohet, në shqip dhe latinisht ('impressus'), nënkuptohet procesi dhe rezultati përfundimtar. Sipas kësaj qasje, ne fitojmë dije duke përdorur si fillim shqisat (por vetëm në nivel shqisor), më pas kujtesën, përvojën dhe mendjen. Ky proces nuk mund të përmbysset. Dhe nga ky proces do të kalojë çdo njeri. Ky proces, rrjedhimisht, mund të reduktohet te koncepti i *Fronetikës Aristoteliane*:

Ne mund të kapim natyrën e urtësisë [*fronetikës*] nëse ne konsiderojmë se çfarë lloj njeriu ne quajmë të urtë. Kështu, mendohet të jetë objektivi i njeriut të urtë që të jetë i aftë që të kundrojë drejtë rreth asaj se çfarë është e mirë dhe e dobishme...Por asnjë nuk kundron rreth gjërave që janë të pandryshueshme...Kështu...urtësia nuk mund të jetë një shkencë apo art; jo shkencë [*epistemologji*] sepse çfarë mund të bëhet është një ndryshor (ajo mund të bëhet në mënyra të ndryshme, ose të mos bëhet fare), dhe jo art [*techne*] sepse veprimi dhe prodhimi janë përgjithësisht të ndryshëm. Sepse prodhimi synon në një fund, sesa te vetja e tij; por kjo është e pamundur në rast veprimi, sepse fundi është thjesht të bësh *mirë*. Çfarë mbetet është ajo që [urtësia] është një gjendje e vërtetë, e arsyetuar dhe e aftë për veprim sa u përket gjërave që janë të mira ose të këqija për njeriun...Ne konsiderojmë se kjo cilësi u përket atyre që kuptojnë artin e kullandrisjes ose shteteve. (Shkronjat kursive në origjinal)

Urtësia, shkurt, është një shkencë e parimeve parësor. Por **natyra mendjes**¹⁴ ndryshon: sipas Aristotelit, gjëndjet e mendjes përmes të cilave ne bartim vërtetësi dhe nuk mashtrohem kurrë rreth gjërave të pandryshueshme ose qoftë edhe të ndryshueshme është njohuria shkencore, urtësia praktike, urtësia filozofike dhe arsytimi intuitiv, dhe nuk mund të jetë një nga këto të treja (d.m.th. urtësi praktike, njohuri shkencore, ose urtësi filozofike), alternativa e mbetur është *arsyetimi intuitiv i cili kap principet e parë*. Më konkretisht:

Mendja është e pandjeshme dhe e papërzierë, dhe princip i lëvizjes: sepse ajo mund të shkaktojë lëvizje vetëm duke mos e lëvizur veten e saj dhe ka kontroll të lartë vetëm duke mos u përzierë...Mendja është një dhe e vazhdueshme në kuptimin që procesi është i tillë, dhe mendimi është identik me mendimet që janë pjesët e saj; këto kanë një bashkim në seri si të numrave, jo një bashkim si një gjerësi hapësinore. Ndaj dhe mendja nuk mund të ketë as këtë lloj bashkimi; mendja është ose pa pjesë ose e

¹⁴ Citoj gjerësisht Aristotelin sepse qasjet moderne janë të pjesshme dhe nuk janë shkakiste, por kryesisht interpretative. Hegel, për shembull, në librin e tij, *Fenomenologjia e Mendjes*, f. 196, nuk e kupton mendjen siç e kupton Aristoteli. Sepse ai ngatërron mendjen me ndërgjegjjen ose e krahason atë me kockat ose e redukton atë me një *gjë*, dhe ndërgjegjjen nuk e kupton, sërish, siç e kupton Aristoteli. Shih për më shumë, Miti i progresit dhe themelet e njohurisë.

vazhdueshme në një mënyrë tjetër si ajo që karakterizon një gjerësi hapësinore...Mendja duket të jetë një substancë e mishëruar brenda shpirtit dhe e pamundur për t'u shkatërruar...Mendimi, dashuria, dhe urrejtja janë ndikime jo të mendjes, por të asaj që ka mendje, përse kohë që ajo e bart atë...mendja duhet të lidhet me atë çfarë mendohet, siç lidhen shqisat me ato që janë të perceptueshme...ndërsa aftësia e perceptimit varet nga trupi, mendja është e ndarë nga ai...**kur mendja është bërë çdo tërësi e objekteve të saj të mundshëm, siç bart një njeri shkencor, kur kjo frazë përdoret nga një njeri që është në të vërtetë një njeri i shkencës (kjo ndodh kur ai është i aftë për të ushtruar pushtetin në varësi të nismës së tij), kushti i saj është i një lloji të mundshëm, por në një kuptim tjetër nga mundësia e cila i paraprinte fitimit të njohurisë duke mësuar ose zbuluar: atëherë mendja gjithashtu është e aftë të mendojë për veten e saj.** Sepse nëse mendja është e mendushme në vetë-vete dhe ajo çfarë mendohet është **-një** në lloj dhe e njëjtë, atëherë ose (a) mendja do t'i përkasë çdogjëje, ose (b) mendja do të përmbajë disa elementë të përbashkët me të gjithë realitetet e tjerë të cilët i bëjnë ata të mendueshëm...Mendja është ajo që është në sajë të të bërit çdogjë, ndërsa atje është një tjetër e cila është ajo çfarë është në sajë të bërjes së çdo gjëje: kjo është një lloj gjëndje pozitive si drita; sepse në një kuptim drita bënë ngjyra të mundshme në ngjyra të vërteta. Mendja në këtë kuptim është e ndarë, e pandjeshme, e papërzierë, meqëse është në natyrën e saj thelbësore veprimi (sepse gjithnjë aktivi është sipëror për faktorin pasiv, fuqia zanafillore e lëndës të cilën ajo formon). Njohuria e vërtetë (aktuale) është identike me objektin e mendjes: për individin, **njohuria e mundshme është pararendëse e njohurisë aktuale**, por në tërësinë e universit ajo nuk është pararendëse as edhe në kohë. Mendja nuk është një herë di dhe një herë tjetër jo. **Kur mendja lihet e lirë nga kushtet aktuale ajo shfaqet thjesht si ajo që është dhe asgjë më tepër: kjo në vetë-vete është e pavdekshme dhe e përjetshme (ne, sidoqoftë, nuk kujtojmë veprimtarinë e saj pararendëse sepse, ndërsa mendja në këtë kuptim është e pandjeshme, mendja si pasive është e shkatërrueshme), dhe pa të asgjë nuk mendon.**¹⁵ (Theksi u shtua)

Megjithëse Aristoteli hedh plotë dritë mbi natyrën e mendjes (vous) ne do ta zgjerojmë pak më tej atë me qëllim që ta kuptojmë më mirë: kështu, që mendja është e ndarë, e pandjeshme dhe e papërzierë me pjesët e tjera të trupit e kuptojmë kur themi (me mendje) më dhemb këmba ose shpirti ose koka (duke nënkuptuar trurin) por kurrë mendja. Në rastin kur ne ndiejmë dhimbje ose kënaqësi — mendja është aktuale por ajo nuk na dhemb. Si e tillë, ajo është njëherësh në tru, trup dhe jashtë tij. Qasja e

¹⁵ Aristotle, *Physics*, f, 96, *On the Soul*, ff, 7-35.

Anaksagoras,¹⁶ të cilën e adopton pjesërisht edhe Aristoteli, se ‘mendja është lëndë e hollë, e lehtë që ngjan me ajrin dhe se ajo paraqitet si princip rregullues që përshkon të gjitha qëniet dhe se ajo nuk përbën ndonjë princip të kapërcyeshëm, të mbinatyrshëm dhe jolëndor, por princip rregullues të botës lëndore: sepse është gjëja më e hollë dhe më e pastër nga të gjitha gjërat e tjera, di gjithçka për çdogjë dhe bart forcën më të madhe dhe se kontrollon të gjitha qëniet me shpirt, më të mëdhat dhe më të voglat’, një qasje që është adoptuar edhe nga filozofë të tjerë më vonë, dhe nga të gjitha fetë, por duke përmbysur principin, se ajo buron nga Zoti dhe jo nga Natyra, është një qasje njëherësh e vërtetë dhe e pjesshme: ‘e vërtetë’, sepse esenca e saj gjëndet në natyrë dhe është e natyrës lëndore dhe çdo qenie e gjallë —me recetore— mund ta bart atë përderisa rritet dhe zhvillohet në tokë; ‘e pjesshme’, sepse ajo pa receptorët e saj (trurin, syrin etj.) nuk mund të marrë formë kognitive dhe kontrolluese të lëndës së saj. Në fjalë të tjera, jeta në tokë është pasojë e teleologjisë së Natyrës ose e kushteve të saj teleologjike sipas ligjit të propabilitetit dhe domosdoshmërisë. Natyra e mendjes që përshkron Aristoteli dhe elementi i hollë dhe i pastër të Anaksagoras mund të kuptohet përmes “grimcës Higgs”. Karakteristika kryesore e fushës gravitacionale të grimcës “higgs” është se ajo nuk i reziston lëvizjes por përshpejtimit, një fushë, që ndryshe nga fusha elektromagnetike, nuk mund të “fiket” por merr një vlerë konstante kudo. Mund të lidhet, gjithashtu, edhe me zbulimin e një lënde të re nga shkencëtarët e cila është teorizuar 50 vitet e fundit: eksitoniumi. Eksitonet janë grimca të pazakonshme të përbëra nga një elektron i arratisur. Ato depërtojnë gjithë lëndët e tjera dhe lënë vrimë në një material. Ekzistenca e eksitoniumit është postuluar që në vitin 1960 nga Bert Halperin: Harvard. Fizikantët e krahasojnë me grimcën Higgs por ata ende nuk janë të sigurtë për cilësitë e saj.

Sidoqoftë, këto grimca mbetet të vërtetohen nga astrofizika.¹⁷ Kështu, truri është receptor i natyrës së mendjes siç është receptor syri kryesisht për dritën. Natyra e trurit, nxënësia dhe pjesët e tij, bartin gjithnjë esencën e mendjes, siç bart drita dhe syri esencën e saj: ‘drita’, sepse ajo është e natyrës grimcore dhe valore; ‘syri’, sepse ai është i natyrës nervore dhe pjesë e një organizmi të tërë dhe, ‘nervat nuk transmetojnë në tru

¹⁶ Shpirti, mendja dhe truri: një prapaktim historik për studimin e marrëdhënieve të tyre, *George T. Panagis & Manolis Dafermos University of Crete, Rethymno, Greece*, f, 330. Këtu autorët bëjnë një përmbledhje të mirë të të gjitha qasjeve lidhur me shpirtin, mendjen dhe trurin nga antikiteti deri në shekullin e XX por keqparaqesin Aristotelin. Dhe kjo, ngaqë e citojnë nga autorë të ndryshëm sesa nga origjinali. Puna është në gjuhën greke.

¹⁷ Shih për më shumë, Drejt idealizmit dhe teorisë demokratike, ku, në pjesën e parë, diskutohet origjina e Universit.

cilësitë objektive të objekteve por funksionet dhe cilësitë e tyre'.¹⁸ Si e tillë, mendja gjëndet te të gjitha kafshët por natyra e saj ndryshon: te njeriu, falë dijes dhe përvojës, ajo është përlllogaritëse ose kalkulative në një shkallë shumë më të lartë se te kafshët e tjera — sepse edhe te kafshët e tjera ekziston një farë përlllogaritje mendore përsa kohë që ato u shmangen vendeve të rrezikshme (greminave etj.) dhe kujdesen për këlyshët, zogjtë etj. Mendja, në fjalë të tjera, falë natyrës së saj, ndërvepron me trurin e njeriut dhe organizmin e tij dhe kontrollon sjelljen. Si e tillë, ajo është e vazhdueshme dhe e mishëruar në të gjithë organizmat e kafshëve dhe bimëve. Me të drejtë, rrjedhimisht, konkludimi i Aristotelit, babait të materializmit dialektik ("heliomorfizmit"), se mendja është e mishëruar në shpirt ndërkohë që shpirti është 'entelektik' (ose bart një qëllim përfundimtar), sepse shpirti bart mendje më shumë se organet e tjerë, meqëse ai është më shumë i natyrës energjitike sesa fizike. Kjo është arsyeja që truri është më shumë empirik — d.m.th. ai lidhet më shumë me kujtesën, ose neuronet e tij janë "folë" kujtimesh ("gestalt"), ndërsa mendja dhe shpirti, në bashkëpunim me trurin dhe ndërgjegjjen, lidhet me shkencën — d.m.th. me shkaqet e dukurive. Siç citon një neurologe natyrën e trurit kur përpiket të krijojë në laborator disa qindra tru artificialë, jashtë trupit dhe nga qelizat (e një trupi), duke kërkuar t'i përgjigjet pyetjes së vjetër shumëvjeçare se për gjithë epërsinë tonë intelektuale, ndryshimi gjenetik mes njerëzve dhe shimpazeve është rreth 1.2%...kjo është vetëm 12 herë më e lartë se ndryshimi mes njerëzve individual (0.1%) që, për t'i dhënë përgjigje, "shkencëtarët" përkatës kryejnë eksperimente duke marrë gene individuale që përfshihen në zhvillimin e trurit dhe i zëvendësojnë ata me variantin e shimpazeve — dhe pastaj përdorin qelizat për të krijuar tru hibrid shimpaze-njeri:

Trutë gjithnjë gumëzhijnë me veprimtari elektrike kur neuronet lëshojnë sinjale shumë të shpejtë kundrejt njëri-tjetrit...ndërsa qelizat e zemrës janë të programuara për të "dëshiruar" për të pompuar, neuronet "dëshirojnë" të ndizen. Qoftë edhe nëse ke një neuron të vetëm në një enë pa ndonjë neuron tjetër, ai dëshiron të ndizet aq keq saqë ai do të bashkohet me veten me qëllim që të ndizet.¹⁹

¹⁸ Në vitin 1826 Johannes Muller do të përcaktojë ligjin e veprimtarive të veçanta ndijimore, sipas të cilit lloji e ndjenjës është një cilësi e fibrës ndijimore të ndjeshmërisë, e cila aktivizohet nga një lloj konkret ngacmimi. Kjo qasje përforcoi mendimin se nevrat nuk transmetojnë cilësitë objektive të objekteve, por funksionet dhe cilësitë e tyre.

¹⁹ We're growing brains outside of the body, BBC, 5 October 2016.

Pa u çuditur “shkencëtarët” në fjalë nuk kuptojnë se si veprimtaria e truve tanë nxit mendimin — dhe është, sipas tyre, e vështirë për t’u përcaktuar se çfarë është në të vërtetë një mendim duke hamendësuar se ai mund të jetë si vijon:

Zakonisht, kur ne ekspozohemi në stimulime nga bota e jashtme — nuhatje, tinguj, ide — trutë tanë magazinojnë informacionin duke forcuar lidhjen mes neuroneve tona ose duke formuar neurone të rinj. Një i rritur mesatar do të ketë më shumë se 1,000 trilion neurone, të cilët bashkë i japin truve tanë një fuqi të njëjtë proceduese me një kompjuter me një trilion bit për sekondë...të ashtuquajturat “valë të trurit” të cilat makineritë mund t’i zbulojnë, shkaktohen si rezultat e miliona neuroneve që ndizen në sinkroni; kur bashkohen, sinjalet e tyre elektrike janë të zbulueshëm përgjatë mbikafkës.²⁰

Mendimin, në fjalë të tjera, e lidhin me neuronet, sinjalet elektrike që ata lëshojnë dhe botën e jashtme! Por elekticiteti nuk është i natyrës së ftohtë. Por përvëlues. Si i tillë, ai nuk mund të jetë burim mendimi. Truri, sipas përshkrimit të mësipërm, ngjan me natyrën e universit. Domethënë, të ‘natyrës’ që kemi kuptuar deri tani: sepse nuk janë zbuluar ende gjithë forcat e saj. Nuk është e rastit që kur afrohem pranë aparateve elektrike dhe veçanërisht radio-televizioneve, ne përmirësojmë valët e transmetimit: sepse neuronet tona, me ngarkesë elektrike, ndërveprojnë me valët elektromagnetike që lëshojnë antenat në atmosferë. Kështu, që mendja e njeriut është e natyrës së mundshme e kuptojmë kur mendojmë ose shqyrtojmë (me mendje) mundësitë tona lidhur me një veprim: ne e ndërmarrim një veprim vetëm kur sigurohemi (nga mendja) se veprimi në fjalë nuk do të shkaktojë dhimbje. Dhe siç citon Aristoteli, njohuria e mundshme është pararendëse e njohurisë së vërtetë (aktuale), d.m.th. kur ne ndërmarrim një veprim ne dimë deri në një farë shkalle probabilitetet por jo rezultatin përfundimtar të një veprimi. Ne mund të dimë rezultatin përfundimtar të një veprimi ose ndërveprimi vetëm kur njohuria është e vërtetë. Domethënë, kur njohim (me mendje) plotësisht fillimin dhe përfundimin e ndërveprimit në fjalë. Nëse punohet, rrjedhimisht, metodologjikisht, mendja mund të shkëputet nga kushtet aktuale dhe nga pjesët e ngrohta të organizmit. Dhe nëse arrihet në këtë fazë — mendja thjesht çliron vetveten. Por kjo s’do të thotë se ajo është e pavdekshme dhe e përjetshme, siç argumentojnë disa spiritualistë, sepse pa receptorët e saj, nuk mund të marrë ose japë formë konkrete. Kur receptorët vdesin — ajo thjesht shkëputet nga organizmi dhe mund të marrë me vete dinamikën e organizmit në të cilin ka dhënë ose marrë formë. D.m.th., ajo gëzon jetë konkrete, siç e perceptojmë

²⁰ Po aty.

dhe konceptojmë ne, përse kohë që zhvillohet bashkë me receptorët ose bartësit e saj. Përjetësia e saj, rrjedhimisht, lidhet me aftësinë e saj për të riprodhuar veten në tokë...

Predikamenti, këtu, rrjedhimisht, është njeriu dhe mendja e tij. Kështu ndërsa shqisat perceptojnë botën e jashtme ashtu siç 'është' dhe ato ia kalojnë përshtypjet trurit — **mendja** është shkaku i lëvizjes së trupit. Ndryshimi midis shqisave dhe mendjes është se shqisat e perceptojnë botën e jashtme thujse njëllor ndërsa mendja procedon ndryshe: sepse ajo procedon shkaqet e botës së jashtme —herë përmes arsyetimit intuitiv dhe instinktiv, nëse bëhet fjalë për veprime që ndërmerren atypëraty — dhe herë përmes hetimit dhe kundrimit. Mendja, në fjalë të tjera, bashkon tërësinë e dinamikave fizike të njeriut dhe i drejton ato: **sa më e pandjeshme dhe papërzjerë me dinamikat fizike të jetë ajo aq më e lartë është shkalla e kontrollit dhe kthjelltësisë së njeriut**. Popujt këtë dukuri e quajnë "mendje e ftohtë". Realizimi i këtij procesi në vetvete nënkupton një lloj metodologjie. Me të drejtë, rrjedhimisht, konkludon Aristoteli se "mendja është shkaku i shkencës": sepse ajo shqetësohet me shkaqet e dukurive sociale dhe natyrale dhe për më tepër me shkaqet përfundimtarë të tyre. Shkurt, atje kemi shkaqe të qartë që perceptohen nga shqisat (drita për sytë për shembull) dhe shkaqe përfundimtarë që procedojnë përmes mendjes.

Shkaqet e qartë dhe përfundimtar (formal and final causes) janë hedhur poshtë nga modernizmi i cili u përqendrua më shumë te "gjërat e njerëzve" sesa te qasja Aristoteliane (Francis Bacon, René Descartes, Thomas Hobbes, Giambattista Vico, David Hume etj.). Por kjo është si të konsiderosh rezultatin dhe jo gjendjen e mendjes. Më vonë Jean-Jacques Rousseau duke ndjekur traditën Aristoteliane e pa natyrën njerëzore si "tabula rasa". Në shekullin e XIX dhe XX u shfaqën shumë qasje të tjera: siç ishte empiricizmi, racionalizmi dhe filozofia kritike, bihevioralizmi, pozitivizmi dhe hermeneutika.²¹ Ka edhe studiues që mundohen të tejkalojnë qasjet e përgjithshme të Rousseau-s dhe Darvinit lidhur me natyrën njerëzore. Merlin Donald, për shembull, nga perspektiva shkencore trunore, orvatet të sqarojë empirikisht për ndërtimin e një përshkrimi universal kulturor të kushtit human dhe të sqarojë "natyrën njerëzore" në terma evolucionarë dhe gjenetik.²² Për ta realizuar këtë objektiv ai ngre dy hamendësime: (1) se njerëzit kanë një tërësi të ngurtë të mjaftueshme shtrëngimesh në jetën e tyre mendore dhe sociale, që imponohet nga një trashëgimi gjenetike e papërkulshme dhe (2) se jeta mendore dhe sociale e njeriut përcaktohet kryesisht nga

²¹ Për një analizë rreth gjithë këtyre disiplinave, shih një përmbledhje dhe kritikë të mirë që ka bërë *Takis Fotopoulos*: How do we justify the Project for an Inclusive Democracy?

²² The new brain sciences, perils and prospects, *Cambridge University*, Merlin W. Donald, 2004.

ndryshorë organizmik, dhe se mendja e njeriut mund të trajtohet si mendja e çdo specie tjetër. Por ai paraqet edhe një qasje tjetër alternative, bazuar në fakte shkencore dhe teorinë evolucionare që nxjerr përfundime të tjera e cila bazohet në një tërësi hamendësimesh: se (1) natyra njerëzore është karakterizuar nga përkulshmëria, jo nga ngurtësia e saj. Kjo, kryesisht për shkak të tejzhvillimit të procesit së ndërgjegjjes, dhe pjesëve të trurit që e mbështesin atë; (2) qenia njerëzore, si specie, ka zhvilluar një simbiozë që lidh zhvillimin e trurit dhe rrjetet kognitive cilësitë e të cilit mund të ndryshojnë rrënjësisht. Aftësitë kritike mendore, siç është gjuha dhe mendimi i bazuar në simbole (si në matematikë) janë bërë të mundur vetëm përmes sistemeve shpërndarës zhvillimor. Vetë kultura ka cilësi rrjeti që nuk gjenden në trutë e individëve. Mendja individuale si e tillë është një produkt hibrid, pjesërisht organizmike në origjinë, dhe pjesërisht ekologjike, që formohet nga një rrjet shpërndarës cilësitë e të cilit ndryshojnë.²³ Shkurt, ai na paraqet dy teori: shtrëngimet mendore të cilat imponohen nga përkulshmëria gjenetike dhe tjetra nga përkulshmëria mendore e cila lidhet me ndërgjegjjen dhe trurin cilësitë e të cilëve ndryshojnë kryesisht në sajë të kulturës.

Përgjithësisht të gjithë këta autorë përqendrohen kryesisht te njeriu dhe kultura²⁴ ndërkohë që shpërnjohin regjimet ose paradigmat sociale dhe historike që ka zhvilluar njerëzimi. Por kjo është si të konsiderosh sjelljen e një fëmije që rritet nga një prind pa konsideruar sjelljen e prindërit kundrejt fëmijës. Sepse çdo shoqëri nënkupton një lloj pushteti: ose mitriarkal, si në rastin kur në disa shoqëri gruaja luante (dhe mund të luajë edhe sot në disa shoqëri) rol vendimtar; ose patriarkal, si në rastin kur burri dominon në shoqëri; ose monarkik, si në rastin kur monarku sundon; ose oligarkik, si në rastin kur oligarkia ushtron pushtet; ose demokratik, si në rastin kur pushtetin e ushtron një popull. Në të gjitha këto forma organizative kultura dhe rrjedhimisht sjellja e njeriut do të jetë e ndryshme. Kjo është arsyeja se përse njerëzimi ka zhvilluar kaq shumë kultura dhe sot, falë globalizmit neoliberal dhe përqendrimit të pushtetit gjithnjë dhe në më pak duar po i njëjtëson ose homogjenizon ato.

Kështu, falë qasjeve të pjesshme ose jo sistemike, bota moderne është themeluar mbi “virtytin” ose “racionalitetin” e kapitalit dhe mbi pasuritë e të pasurve —fakt që nuk kërkon shumë mend për ta kuptuar. Mendtë duhen, në këtë rast, për të kundruar se çfarë shkakton (ose shkatërron) pasuria e tepërt dhe “kapitali”, te virtytet njerëzore,

²³ Po aty, ff, 35-36.

²⁴ Shih, për shembull, Human nature and culture: an evolutionary psychological perspective, David M. Buss, University of Texas, Austin, 2001.

d.m.th., se nëse një i pasur zhvillon ndonjë virtyt, zotëron ndonjë virtyt apo shkatërron ndonjë virtyt?

Sipas Aristotelit, 'virtyti nënkupton synim dhe vijueshmëri ose konsistencë'.²⁵ Për të njëjtën arsye, në një shoqëri ku dominon përfitimi, synimi do të jetë objektivi që dominon mendjen: paraja! Dhe meqëse një lloj synimi kërkon konsistencë që të realizohet, në mendjen e njeriut modern dominon masivisht kapitali ose përfitimi, i cili buron nga tregu dhe nga njeriu — dhe jo nga Natyra dhe kultivimi dhe mirëkullandrisja e burimeve të saj. Në këtë mënyrë vlerat dominante të një shoqërie dominojnë natyrën e dijes. Fjala 'dije' në vetvete nënkupton një objekt të caktuar, të cilin nëse kërkojmë ta njohim më shumë, ne duhet ta ndajmë atë në dy pjesë ('di' është rrënja e shumë fjalëve edhe në greqisht dhe ka kuptimin e ndarjes ose depërtimit, brenda një objekti), dhe çdo pjesë, në pjesë të tjera. Siç edhe fjala nënkupton, dija fitohet ose përftohet përmes depërtimit në brendësi të një objekti. Depërtimi në brendësi të objekteve fizikë është i thjeshtë por në sisteme sociale është i vështirë ose të paktën kështu duken kur sistemet nuk kuptohen. Dhe meqëse **të gjithë njerëzit nga vetë natyra kërkojnë të dinë**,²⁶ ata kanë shumë mundësi të kuptojnë kontradiktat e sistemeve historike me natyrën njerëzore. Dhe duke kuptur, ndryshojnë jo vetëm sistemin por edhe veten.

Shkurt, njeriu është "tabula rasa". Ndërsa ai lind me tre instinkte — të imitimit, të shoqërisë, dhe të harmonisë — virtytet i fiton përmes edukimit. Si i tillë, mbi mendjen e njeriut mund të shkruhet më shumë se sa ç'është shkruajtur në "kodin" gjenetik. Por 'shkrimi' në mendje nënkupton aftësi edukative. Sepse siç citon Aristoteli, **'treguesi i vetëm i veçantë i njohurisë së plotë është aftësia e mësimitdhënies. Sepse veçoria e një mendje të edukuar është aftësia e saj për të shqyrtuar një mendim pa e pranuar atë'**.²⁷ Kjo do të thotë se kuptimi i edukimit në lidhje me shoqërinë dhe dinamikat e saj,²⁸ është vendimtar në sjelljen e njeriut dhe kuptimi i natyrës së mendjes dhe virtyteve dhe, zhvillimi i tyre,²⁹ janë realitete të ndryshme që krijohen përgjatë ushtrimit të pushtetit dhe baza përmes të cilit njeriu kalon në veprim racional: sepse **edukimi**, siç citon me vend Aristoteli, **është shpëtimtar në kohë të keqe dhe luks në kohë të mirë...**

Pyetje për hetim të mëtejshëm:

²⁵ Shih, për më shumë, Drejt demokracisë virtuoze.

²⁶ Aristotle, *Metaphysics*, Book I.

²⁷ Nga citimet e tij të shumta.

²⁸ Shih, për më shumë, Nga keqedukim në arsim demokratik.

²⁹ Shih, për më shumë, Gjenealogjia dhe forca e dashurisë.

Psikologët në mungesë të kuptimit të natyrës së mendjes — për të kuruar depresionin, për shembull, i cili në globalizmin neoliberal është kthyer në epidemi, japin kura ose ilaçe psikosomatike të cilat, në të vërtetë, çaktivizojnë trurin nga realiteti i mendjes dhe e vënë në gjumë. Por karakteristika kryesore e një depresanti është ‘fiksimi’ në një shqetësim të veçantë dhe pagjumësia —në kohën kur gjumi është ushqimi i dytë i njeriut— kura në këtë rast, do të ishte çfiksimi. Kujto këtu sjelljen e fëmijës. Kjo mund të bëhet përmes edukimit të njeriut që vuan nga depresioni dhe njerëzve që e rrethojnë. Për shembull, përpara se të flenë gjumë, bashkshorti ose fëmijët e të sëmurit, duhet të shtrojnë për diskutim një shqetësim, qoftë edhe duke cekur shqetësimin në fjalë, nëse “nuhatet”...dhe ta diskutojnë gjerë e gjatë. Ky proces e çorieton të sëmurin nga shqetësimi i tij. Dhe nëse burrë e grua flenë bashkë, njëri t’i flas dhe pëshpërisë tjetrit, deri sa ta çorientojë nga fiksimi në fjalë. Këtë proces mund ta ndihmojnë edhe aromat bimore gjumndjellëse që shpërbëhen në ajër ose në një gotë verë ose në të dyja bashkë. Por kura më e mirë është edukimi i njeriut: se si ai të mos fiksohet. Ky është një proces tjetër që psikologët dhe mësuesit duhet ta njohin: d.m.th. ata duhet të mësojnë individin të mendojë shkencërisht.³⁰ Nga padija, njerëzit fetarë, për shembull, në ceremoni mortore thonë: “iu preftë shpirti në paqe”. Por vallë cila është natyra e shpirtit? Sa mundësi ka shpirti të prehet në paqe kur natyra (e ngrohtë dhe e nxehtë) e universit s’është edhe aq e paqë? Në të vërtetë, natyrë të paqë ka vetëm mendja por ajo nuk studiohet nga shkenca moderne.

Përse, atëherë, natyra e mendjes është e paqë dhe si mund ta aktivizojmë atë në shpirt kur natyra e shpirtit është kryesisht energjitike dhe e barabartë me masën fizike?

³⁰ Drejt orientimit ekologjik të shoqërisë.